

VLERËSIMI I GRUPEVE TË KOLEGËVE SI NJË QASJE EFEKTIVE E EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PËR OFRUESIT E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR NË SHQIPËRI

RELACION PËR HARTUESIT E POLITIKAVE (POLICY BRIEF)

Përgatitur nga:

Prof. As Jolanda Hyska

Korrik 2025



HYRJE

Profesionistët në kujdesin shëndetësor parësor përballen me sfida të vazhdueshme për të përditësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre. Edukimi tradicional në vazhdim është shpesh teorik, jo i personalizuar dhe jo i lidhur me nevojat reale të praktikës së mjekësisë së familjes. Ka nevojë për një qasje të qëndrueshme, që mundëson reflektim profesional, ndryshim të sjelljes klinike dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së kujdesit shëndetësor parësor.

Grupet e Kolegëve (GK) përdoren si një mjet i Edukimit në Vazhdim (EV) për profesionistët e shëndetësisë dhe për forcimin e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP), pasi ato ofrojnë një forum të strukturuar ku klinikistët ndajnë përvoja, analizojnë raste dhe reflektojnë mbi praktikën. Kjo qasje bashkëpunuese përdoret nga shumë vende evropiane si një formë për të nxitur mendimin reflektues, të nxënit gjatë gjithë jetës dhe përgjegjshmërinë profesionale. Nëpërmjet diskutimit të udhëzuesve të bazuar në evidencë dhe sfidave reale të praktikës, pjesëmarrësit në grupe identifikojnë boshllëqet, pakësojnë gabimet dhe përafrohen me praktikat më të mira.

Njohja zyrtare e GK si formë e edukimit në vazhdim është përcaktuar në Strategjinë e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP) 2020-2025. Gjithashtu, detyrimet kontraktuale të qendrave shëndetësore (QSH) me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) theksojnë domosdoshmërinë e aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim në vendin e punës duke i cilësuar si Grupet e Kolegëve si një metodë efektive, interaktive dhe të bazuar në evidencë për përmirësimin e praktikës mjekësore dhe profesionalizmin. Ku kuadër rregullator përbën një terren favorizues e premtues për vazhdimësinë dhe shtrirjen në shkallë kombëtare të kësaj qasjeje.

Megjithatë, përhapja dhe qëndrueshmëria e GK-ve mbeten të brishta për shkak të mungesës në nivel sistemi të faktorëve nxitës dhe të vlerësimit të kësaj metode. Për më tepër, ka nevojë për një mjedis nxitës dhe motivues për integrimin e plotë të kësaj qasjeje në politikat dhe planet kombëtare të zhvillimit profesional të stafit në KSHP-së.



NEVOJA PËR VLERËSIM, OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË GRUPEVE TË KOLEGËVE

Evidenca shkencore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dëshmojnë se Grupet e Kolegëve përfaqësojnë një model të provuar efektiv dhe të qëndrueshëm të edukimit profesional në kujdesin shëndetësor parësor. Në Shqipëri, gjatë gati një dekade, GK-të janë transformuar nga një nismë pilot, e mbështetur nga projekti HAP, në një formë të strukturuar dhe të institucionalizuar të edukimit të vazhdueshëm profesional (EV) në kujdesin shëndetësor parësor.

Në këtë fazë të zhvillimit, kur GK-të janë shtrirë gjerësisht dhe kanë fituar njohje institucionale, ishte i domosdoshëm një vlerësim i thelluar dhe gjithëpërfshirës i kësaj qasjeje si një model inovativ i Edukimit në Vazhdim (EV) për profesionistët e kujdesit parësor. Vlerësimi u realizua në vitin 2025 nga një ekspert shqiptar dhe synoi të vlerësonte ndikimin e Grupeve të Kolegëve në zhvillimin profesional dhe praktikën klinike të profesionistëve të kujdesit parësor. Vlerësimi kishte për synim: 1) të dokumentojë praktikat efektive dhe sfidat kryesore të zbatimit në realitetin klinik të asaj që mësohet dhe praktikohet në GK; 2) të identifikojë faktorët që ndikojnë dhe përcaktojnë qëndrueshmërinë e tyre; 3) të ofrojë rekomandime të mbështetura në fakte për konsolidimin e GK-ve si një komponent i qëndrueshëm dhe i integruar i sistemit kombëtar të edukimit të vazhdueshëm profesional. Nëpërmjet këtij vlerësimi, politikëbërësit dhe institucionet përgjegjëse kanë në dorë informacionin e nevojshëm për të marrë vendime të informuara mbi mbështetjen, financimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj forme fleksibël të EV-së.

Metodologjia u ndërtua mbi tre komponentë kryesorë: 1) rishikimin sistematik të literaturës, 2) intervistat e thelluara me informatorë kyç (9 persona) dhe, 3) shtatë fokus-grupet me profesionistë të ndryshëm të KSHP-së me përvojë me GK-të si pjesëmarrës apo

facilitatorë. Pjesëmarrësit u përzgjedhën në mënyrë të qëllimshme për të siguruar një përfaqësim të gjerë dhe të balancuar të perspektivave profesionale dhe institucionale lidhur me temat e vlerësimit.

Në vijim pasqyrohen gjetjet kryesore të vlerësimit dhe rekomandimet që rrjedhin prej tyre.

NDIKIMI I GRUPEVE TË KOLEGËVE NË PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKËS DHE ZBATIMIN E POLITIKAVE SHËNDETËSORE NË KUJDESIN PARËSOR

Grupet e Kolegëve kanë ndikuar në mënyrë domethënëse në tri fusha kyçe të funksionimit të sistemit të kujdesit shëndetësor parësor, si më poshtë:

- » **Përmirësimi i praktikës klinike dhe cilësisë së shërbimeve:**
 - » Rritje e kompetencës klinike, vetëdijes profesionale dhe vetëbesimit të mjekëve, infermierëve dhe psikologëve, duke çuar në ofrimin e një kujdesi më efektiv për pacientët, veçanërisht ata të prekur nga sëmundjet kronike.
 - » Zbatimi më i mirë i protokolleve klinike dhe standardizim i praktikës në përputhje me udhëzuesit/protokollet kombëtare.
 - » Zgjerimi i rolit profesional të infermierëve dhe psikologëve, duke përfshirë ofrimin e kujdesit në banesë.
 - » Përafrimi i praktikës klinike me prioritetet strategjike të sistemit shëndetësor.
- » **Forcimi i bashkëpunimit ndërprofesional dhe punës në ekip:**
 - » Përmirësim i dinamikës së bashkëpunimit ndërmjet profesionistëve në qendrat shëndetësore (QSH), që rrit besueshmërinë dhe krijon mjedis të sigurtë, duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta për pacientët, veçanërisht ata me sëmundje kronike.

- » Ndarje më e qartë e roleve dhe përfshirje më aktive në kujdesin ndaj pacientit e të gjithë anëtarëve të ekipit, veçanërisht infermierëve dhe psikologëve.
 - » Promovim i një kulture bashkëpunuese, duke tejkaluar qëndrimet hierarkike dhe individualiste.
 - » Mbështetje për mirëqenie emocionale, psikologjike dhe sociale të kolegëve.
- » **Kontributi në zbatimin e politikave shëndetësore kombëtare:**
- » Mbështetje konkrete për realizimin e objektivave të Strategjisë për Zhvillimin e Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020–2025 dhe Programit për Sëmundjet Jo të Transmetueshme 2021–2030.
 - » Forcimi i zhvillimit profesional dhe standardizimi i menaxhimit të SJT-ve, integrimi i KSHB-së, shëndetit mendor, kujdesi për të moshuarit në KSHP.
 - » Lidhje më e fortë ndërmjet politikave shëndetësore dhe praktikës në terren, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e shëndetit të komunitetit.



PENGESAT PËR ZBATIMIN NË PRAKTIKË TË NJOHURIVE TË FITUARA NGA GRUPET E KOLEGËVE

Pavarësisht vlerës së shtuar që ofrojnë Grupet e Kolegëve (GK) në përmirësimin e kompetencave klinike dhe bashkëpunimit ndërprofesional, disa faktorë vijojnë të kufizojnë zbatimin në praktikën e përditshme klinike të asaj që mësohet dhe praktikohet në GK.

Sfidat kryesore në nivelin e QSH-ve

- » Mungesë e mekanizmave të motivimit të profesionistëve të KSHP-së të lidhur me performancën dhe cilësinë e kujdesit.
- » Bashkëpunimi i dobët ndërprofesional (në disa raste) brenda ekipeve të KSHP, për shkak të mungesës së besimit, përjashtimit të infermierëve nga rolet klinike dhe ndarjes jo të qartë të përgjegjësisë.
- » Boshllëqet në formimin bazë të infermierëve, që kufizojnë aftësinë e tyre për të aplikuar njohuritë e fituara nga GK.
- » Disa nga profesionistët e kujdesit shëndetësor parësor nuk marrin pjesë në GK (në disa raste). Kjo kufizon shpërndarjen e njëtrajtshme të njohurive dhe dobëson bashkëpunimin ndërprofesional, duke cenuar cilësinë dhe vazhdimësinë e kujdesit.
- » Mungesa e mekanizmave sistematikë për vlerësimin e ndikimit të GK-ve, si dhe mbikëqyrje e dobët mbështetëse nga drejtuesit e QSH-ve, që kufizojnë integrimin e praktikës së GK-ve në qasjet më të gjera për përmirësimin e cilësisë së kujdesit.

Sfidat kryesore në nivelin makro

- » Konteksti i përgjithshëm i praktikës në KSHP (burime të pamjaftueshme, pajisje mjekësore dhe materiale konsumi të pamjaftueshme, si dhe mbingarkesë në punë, veçanërisht në zonat urbane) nuk e favorizon zbatimin e protokolleve klinike dhe ndjekjen aktive të pacientëve në komunitet.

- » Ekzistojnë mospërputhje ndërmjet protokolleve klinike dhe skemës së rimbursimit të barnave nga FSDKSH, çka krijon pasiguri dhe demotivim të mjekët për zbatimin e skemave të reja të mjekimit.
- » Mungesa e sistemeve funksionale që mundësojnë planifikimin e vizitave (sistemi i vizitave) për anëtarët e ekipit të mjekësisë familjare, për një menaxhim më efikas të kohës dhe burimeve njerëzore.

PRAKTIKAT MË TË MIRA DHE FAKTORËT KRITIKË PËR FUNKSIONIMIN E SUKSESSHËM TË GRUPEVE TË KOLEGËVE

Përvoja në terren tregon se Grupet e Kolegëve funksionojnë më mirë kur plotësohen këta elementë kyç:

- » Mbështetje fillestare për trajnimin e facilitatorëve dhe hartimin i materialeve didaktike të dedikuara praktikës së mjekëve të familjes (MF), sipas çështjes përkatëse, nga aktorë të besueshëm (si projekti HAP), e ndjekur nga angazhimi i autoriteteve dhe institucioneve shëndetësore përgjegjëse.
- » Drejtori i QSH-së është i vetëdijshëm për përgjegjësinë për të mbështetur aktivitetet e Edukimit në Vazhdim në vendin e punës, përfshirë edhe GK-të.



- » Mekanizma motivimi për profesionistët që marrin përsipër rolin e facilitatorit të GK-ve.
- » Zgjedhja e temave praktike në përputhje me nevojat dhe kontekstin aktual lokal klinik të shërbimit, si përdorimi i Udhëzuesve të rinj Klinikë për SJT-të, edukimi shëndetësor për parandalimin e SJT-ve dhe komplikacioneve të tyre, kujdesi për të moshuarit në KSHP, menaxhimi i shëndetit mendor në KSHP, rregullimi dhe procedurat e standardizuara të shërbimeve të kujdesit në shtëpi, etj.
- » Përbërje ndërprofesionale e GK-ve, çka nxit këndvështrime të ndryshme dhe mësim të ndërsjellë.
- » Komunikim i qartë midis facilitatorëve, anëtarëve të GK-ve dhe drejtorëve të QSH-ve, si dhe organizim fleksibel i GK-ve (funksionimi i GK-ve me grupe paralele, ndarja e rolit të facilitatorit midis dy ose më shumë profesionistëve, orar i përshtatshëm për takimet e GK-ve) në përputhje me kontekstin aktual të punës në QSH.
- » Metoda interaktive, përfshirë diskutimin e rasteve konkrete nga praktika e përditshme.
- » Motivim i dyfishtë, përmes përfitimeve konkrete në praktikë dhe vlerësimit motivues me kredite.
- » Qëndrueshmëri në përbërje, me përfshirje graduale të anëtarëve të rinj.

- » Shpërndarja/zbatimi i njohurive të fituara në GK me kolegët në vendin e punës.


Në të kundërt, dobësimi i funksionimit dhe jetëgjatësisë së GK-ve ndodh kur:

- » Mungon angazhimi dhe përgjegjësia e drejtuesve të QSH-ve për të mbështetur GK.
- » Profesionistët kanë motivim të ulët për të kryer rolin e facilitatorit.
- » Profesionistët kanë motivim të ulët të brendshëm për zhvillim profesional.
- » Ka mungesë materialesh didaktike dhe burimesh mbështetëse.
- » Nuk sigurohen hapësira të përshtatshme për zhvillimin e takimeve.
- » Akreditim jo motivues nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror për pjesëmarrjen në GK.
- » Ngarkesa klinike dhe administrative është e lartë, duke kufizuar mundësinë reale për pjesëmarrje dhe angazhim cilësor.

DREJTIMET E REKOMANDUARA PËR POLITIKËBËRJE PËR KONSOLIDIMIN E GRUPEVE TË KOLEGËVE SI KOMPONENT I QËNDRUESHËM DHE I INTEGRUAR I SISTEMIT TË EDUKIMIT NË VAZHDIM NË KSHP NË SHQIPËRI

1. PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR

- » Përfshirja e mbështetjes për GK në politikat kombëtare të fuqizimit të kujdesit parësor, kontrollin e SJT-ve si edhe të zhvillimit të burimeve njerëzore në shëndetësi dhe në buxhetet vjetore.
- » Mbështetja e ngritjes dhe funksionimit të GK-ve përmes alokimit të fondeve të veçanta në planifikimin vjetor të buxheteve të QSH-ve.
- » Përditësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për EV-në, në përputhje me strukturën dhe profilin e QSH-ve.



- » Rishikimi i sistemit të akreditimit për të pasqyruar drejt angazhimin real në GK dhe për të motivuar pjesëmarrësit.
- » Përfshirja e ndjekjes/monitorimit të përparimit të GK-ve në skemat e vlerësimit të cilësisë në KSHP.

2. FORCIMI I MBËSHTETJES INSTITUCIONALE

- » Të përmirësohet bashkëpunimi ndërinstytucional midis MSHMS-së, ASCKSH-së, dhe Operatorit për rritjen e cilësisë së akreditimit të GK-ve.
- » Të riaktivizohen dhe fuqizohen rolet e koordinatorëve lokalë të EV-së pranë NJVKSH-ve.
- » Të rriten kapacitetet monitoruese të ASCKSH-së për të mbështetur cilësinë e GK-ve.
- » Të hartohen dhe vihen në dispozicion materiale didaktike për GK-të (Shoqatat e profesionistëve, Urdhrat profesionalë, Institucionet akademike).

3. ZBATIMI I KUADRIT RREGULLATOR NË PRAKTIKË

Drejtuesit e QSH-ve duhet të:

- » Realizojnë vlerësim vjetor të nevojave për trajnim të stafit dhe një plan për forcimin e kapaciteteve për bashkëpunëtorët që ata mbikëqyrin.
- » Hartojnë dhe zbatojnë plane vjetore për EV, përfshirë GK-të.
- » Sigurojnë që të paktën 30% e krediteve nëpërmjet EV të përfitohen në vendin e punës.
- » Shfrytëzojnë 5% të fondit të QSH-së për shpenzimeve operative për EV, përfshirë mbështetjen për GK-të.

- » Raportojnë rregullisht për realizimin e këtyre detyrimeve, të cilat të përfshihen në vlerësimin e performancës.
- » NJVKSH-të dhe ASCKSH duhet të promovojnë modelet e suksesshme dhe të lehtësojnë shkëmbimin e praktikave të mira midis QSH-ve.

4. MBËSHTETJE E DEDIKUAR PËR FACILITATORËT

- » Roli i facilitatorëve të njihet në sistemin e vlerësimit të performancës dhe karrierës.
- » Të parashikohen stimuj moralë dhe financiarë për facilitatorët e GK-ve.
- » Të ofrohen trajnime të rregullta për rolin e facilitatorit (Shoqatat e profesionistëve, Urdhrat profesionalë, Institucionet akademike) dhe ASCKSH të ofrojë udhëzues të përmirësuar për facilitatorët.
- » Të thjeshtohen procedurat e aplikimit dhe raportimit të ASCKSH

5. KRIJIMI I SISTEMEVE PËR VLERËSIMIN DHE MONITORIMIN E NDIKIMIT

- » Të zhvillohen indikatorë për matjen e performancës dhe ndikimit të GK-ve, të lidhura me rezultatet klinike dhe kënaqësinë e pacientëve.
- » Të krijohet një databazë kombëtare për gjurmimin, dokumentimin dhe analizën e funksionimit të GK-ve në sistemin e kujdesit parësor.
- » Të kryhen vlerësime të efektivitetit të GK-ve si kërkime operacionale në bashkëpunim me institucionet akademike.